



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, në pajtim me Rregulloren MF - Nr - 04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe nenit 61 parag. 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, pas publikimit të rezultateve përfundimtare nga ana e Komisionit të përzgjedhjes së OJQ-ve/ Klubeve sportive për financim publik të aktiviteteve sportive, datë 29.11.2022, Kryetari i Komunës, merr:

VENDIM

PËR MBËSHTETJE FINANCIARE OJQ- KLUBET SPORTIVE NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Neni 1

Për financim publik të OJQ-ve-Klubeve sportive për realizimin e aktiviteteve sportive, sipas Thirrjes publike dt. 23.08.2022, ndahen mjete financiare në shumë të përgjithshme **7600 €**.

Neni 2

Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit për kushtet dhe mënyrën e realizimit të aktiviteteve sportive dhe për mënyrën e financimit publik, me secilin përfitues të mbështetjes financiare lidhë kontratë me shkrim në përputhje me Rregulloren mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe procedurën e përcaktuar në Udhëzimin për aplikuesit.

Neni 3

Lista përfundimtare e përfituesve me shumat përkatëse është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Neni 4

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.prot. 02-400/63-0038202/22
Podujevë, dt. 30.11.2022



Kryetari i Komunës
Shefqet Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Bazuar në nenin 62 pika 3, të ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040. Rregulloren MF-Nr.04/2017, mbi kriteret standarte dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neni 61 paragrafi 1 dhe 2 të statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01-0050862/18 dhe vendimit të Kryetarit të Komunës për shpalljen e thirrjes publike për mbështetje financiare publike të projekte/programave të organizatave joqeveritare në Komunën e Podujevës nr. Protokollit 09-615/02-0071631/22, të datës 23.08.2022.

Lista përfundimtare e përfituesve për mbështetje financiare për projekt-propozimet e
OJQ-ve - Klubeve Sportive

Nr.	Nr. Protokollit	Aplikuesi	Periudha e zbatimit të projektit	Shuma e aprovuar
1.	09-660/01-0079169/22	OJQ - Klubi Atletik "Llapi"	2022	800 E
2.	09-660/11-0074628/22	OJQ - Klubi i Basketbollit "Llapi"	2022	800 E
3.	09-660/01-0079103/22	OJQ - Klubi i Futbollit Futsal "BB.Llapi"	2022	800 E
4.	09-660/01-0078545/22	OJQ - Qendra Sportive Rekreative "Kroni"	2022	800 E
5.	09-660/01-0079196/22	OJQ - Shkolla e Volejbollit "Llapi"	2022	800 E
6.	09-660/01-0079203/22	OJQ - Shkolla e Futbollit "Liridoni"	2022	600 E
7.	09-660/01-0078710/22	OJQ - Shkolla e Futbollit "Besiana 09"	2022	600 E

8.	09-660/01-0078010/22	OJQ - Klubi i Futbollit Podujeva	2022	500 E
9.	09-660/01-0079284/22	OJQ - Shoqata e Arsimitarëve Sportiv	2022	500 E
10.	09-660/01-0079178/22	OJQ - Klubi i Gjmnastikës "Llapi"	2022	400 E
11.	09-660/01-0078551/22	OJQ - Klubi i Karatesë "Llapi"	2022	400 E
12.	09-660/01-0079165/22	OJQ - Klubi i Shahut "Hyzi Talla"	2022	300 E
13.	09-660/01-0079186/22	OJQ - FC Dardanët	2022	300 E

Nga lista preliminare është larguar aplikuesi i OJQ-Klubi i futbollit të femrave Llapi, pasi i njëjti ka qenë përfitues në thirrjen e RELOAD, projekt i përbashkët me Komunën e Podujevës, në vlerë 10,000.00 euro.

Antarët e Komisionit vlerësues për shqyrtimin e aplikacioneve për financimin publik të projekt programeve të OJQ - Klubeve Sportive nga Thirrja Publike, për organizimin e aktiviteteve Sportive në Komunën e Podujevës.

Ejup Babatinca	Kryetar i Komisionit, Udhëheqës i sektorit të Ekonomisë - DPZHE	
Xhevrie Beqiri	Anëtare, Zyrtare për kthim të qëndrueshëm, 1-Zyra komunale për komunitete dhe kthim- ZKK	
Florie Humolli	Anëtare, Zyrtare ligjore, Drejtorja e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë - DPKGJ	
Gramos Latifi	Anëtar, Shoqëria civile	
Viona Bunjaku	Anëtare, Shoqëria civile	

Kundër vendimit të Komisionit Vlerësues aplikantët mund të ushtrojnë ankesë pranë Komisionit të Ankesave brenda periudhës 5 (pesë) ditë pune, nga data: 29.11.2022 deri me datë 05.12.2022